



FUNDACIÓN ASAMBLEA DE CIUDADANOS Y CIUDADANAS DEL MEDITERRÁNEO (FACM)

FONDATION ASSEMBLÉE DES CITOYENS ET CITOYENNES DE LA MÉDITERRANÉE (FACM)

MEDITERRANEAN CITIZENS' ASSEMBLY FOUNDATION (MCAF)

مؤسسة مجلس مواطني و مواطنات المتوسط

ASAMBLEJA E QYTETARËVE DHE QYTETAREVE TË MESDHEUT : DREJT NJË KOMUNITETI MESDHETAR TË POPUJVE

Dokumenti themelues

31 maj 2009



FUNDACIÓN ASAMBLEA DE CIUDADANOS Y CIUDADANAS DEL MEDITERRÁNEO (FACM)
FONDATION ASSEMBLÉE DES CITOYENS ET CITOYENNES DE LA MÉDITERRANÉE (FACM)
MEDITERRANEAN CITIZENS' ASSEMBLY FOUNDATION (MCAF)
مؤسسة مجلس مواطني و مواطنات المتوسط

1. PARATHËNIE

Ideja e asamblesë qytetare ka lindur nëpërmjet punimeve të Aleancës për një botë të përgjegjshme, shumëplanëshe dhe bashkëpërgjegjëse e cila “ushqen” punët e mbështetura nga Fondacioni Charles Léopold Mayer për Progresin e Njeriut që prej vitit 1988.

Aleanca është ndërtuar sipas tre drejtimeve: gjeokulturor; kolegjal dhe tematik. Midis viteve 1995-2000, kjo dinamikë ndërkulturore dhe ndërkombëtare është jetësuar nga pothuaj se njëqind projekte tematike, rrjete socio-profesionale dhe grupe gjeokulturore.

Punimet e Aleancës kanë përbërë një përpjekje të pashoqe për të vënë në jetë një proces social të shumëfishtë të aftë për të përmbledhur kompleksitetin e një bote bashkëkohore dhe për të tejkaluar ndjenjat pafuqinë individuale dhe kolektive me të cilat përballen qytetarët e ndryshëm përballë çështjeve të reja të globalizimit.

Që nga viti 2008; një grup i qytetarëve dhe qytetareve të Mesdheut janë angazhuar aktivisht në formësimin e një komuniteti mesdhetar të popujve. Për të bërë këtë të mundur ato kanë iniciuar procesin e krijimit të një Asambleje të Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut. Në këtë fazë të parë ato kanë përpunuar një akt themelimi bazuar në këtë dokument themelues.

Ky proces është bazuar në vlerat demokratike të lirisë, të paqes, të respektit ndaj kulturave të ndryshme dhe ndaj përgjegjësisë mjedisore. Ai kërkon që të favorizojë formësimin e fjalës dhe veprimin qytetar të përbashkët, për realizimin e takimeve të vazhdueshme që përdorin mjete dhe metoda novatore.

Kjo iniciativë është plotësuese e eksperiencave ekzistuese dhe bazohet megjithatë e gjitha në një përfundim: krijimi i një “komuniteti fatesh” të përbashkëta dhe pozitiv mund të bëhet i mundshëm në hapësirën Mesdhetare kryesisht nëpërmjet veprimin dhe përfshirjes së qytetarëve dhe qytetareve.

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut nuk është një ndërmarrje e cila i drejtohet një numri të vogël personash, apo një grupi të diturish. Por tërësia e procesit kërkon një grupim sa më të madh, të arrihet pjesëmarrja e një grupi të madh dhe i shumëllojshmërie të gjerë personash.

Përfundimet e përbashkëta

Pavarësisht kompleksitetit të realitetit Mesdhetar, ne, Qytetarët dhe Qytetaret Mesdhetare; kërkuam që të nxjerrim në mënyrë kolektive në pah një grup konstatimesh të përgjithshme, me të cilat ne të gjithë jemi tërësisht dakord.

- Megjithëse uniteti dhe tërësia e tij politike nuk janë akoma të vërtetuara, **rajoni i Mesdheut është në të vërtetë një realitet historik, njerëzor, tregtar,**



kulturor, social dhe mjedisor. Ky realitet nuk është i parëndësishëm, ndaj ai duhet të rikujtohet dhe të nxirret në pah. Në të vërtetë, **ky realitet ka humbur**, në mënyrë të veçantë pas Luftës së Dytë Botërore, si pasojë e krijimit të një aksi Atlantik të fortë dhe ndërtimit të Bashkimit Evropian në Veri të Mesdheut, si edhe të integritimit në këtë Bashkim të shumë vendeve të bregut Veri-Lindor. Këto integritime rajonale apo politike kanë mundur që të kthejnë në mënyrë të qëndrueshme të vendeve përreth Mesdheut.

- **Dështimi i tentativave për ndërtimin e disa entiteteve** në Jug dhe në Lindje të Mesdheut është tashmë i dallueshëm qartë.
- Ekziston **një kontradiktë e fortë** midis qarkullit të lirë të fluksit të mallrave dhe të kapitaleve, dhe të kufizimeve të vendosura për qarkullimin e personave.
- Shfaqja e **tensioneve midis zonave me tradita fetare** të ndryshme është një realitet shqetësues.
- **Vendet e rajonit ballkanik**, njohin vështirësi si pasojë e tranzicionit ekonomik dhe politik, konfliktet etnike dhe të minoriteteve pësojnë apo refuzojnë izolimin. Është e pamundur që të dihet në mënyrë të saktë se si – për këto vende ashtu si edhe për të gjithë vendet e Mesdheut – **do të pranohet dhe jetohet nga Qytetarët dhe Qytetaret roli i dyfishtë**, nga njëra anë në Evropë, dhe në Mesdhe nga ana tjetër.
- Në fund si mund të mos vëmë re se marrëdhëniet ekzistuese midis vendeve që janë të zhvilluara në nivele të ndryshme, **shumë shpesh të bazuara në një logjikë dypalëshe**, dhe radhë herë shumëpalëshe?

Ne jemi të ndërgjegjshëm që çështja mesdhetare në këto kushte është komplekse dhe ndoshta e vështirë. **Megjithatë, ne jemi të bindur që ajo është absolutisht e domosdoshme.**

Sfida kryesore dhe akset strategjike

Sfida kryesore është ai i ndërtimit të një komuniteti mesdhetar të popujve. Për t'ju përgjigjur, bëhet fjalë para së gjithash për të identifikuar **disa akse kryesore strategjike**.

Ne mendojmë që sot është e nevojshme:

- **të veprojmë nga një pikëpamje qeverisjeje të bashkërenduar, të pjesëmarrëse, të adaptuar për hapësirën Mesdhetare.** Këtu padysim që nuk bëhet fjalë për të vendosur një model unik të qeverisjes, paraekzistues dhe të paadaptuar për tërësinë e vendeve Mesdhetare. Është e nevojshme që të gjithë pjesëtarët e shoqërive të marrin pjesë në përkufizimin dhe konceptimin e një modeli të funksionimit që të jetë në të njëjtën kohë i respektueshëm ndaj veçorive të secilit duke lejuar gjithashtu reflektimin dhe veprimin e përbashkët;
- **të punohet për të ulur nivelin e izolimit të vendeve** që janë akoma shumë të mbyllura në kufijtë kombëtarë apo të përjashtuara për arsye ekonomike dhe politike- në mënyrë të veçantë në Jug dhe në Lindje të Mesdheut;



FUNDACIÓN ASAMBLEA DE CIUDADANOS Y CIUDADANAS DEL MEDITERRÁNEO (FACM)

FONDATION ASSEMBLÉE DES CITOYENS ET CITOYENNES DE LA MÉDITERRANÉE (FACM)

MEDITERRANEAN CITIZENS' ASSEMBLY FOUNDATION (MCAF)

مؤسسة مجلس مواطني و مواطنات المتوسط

- **të kontribuojë në tejkalimin e disa shqetësimeve të ndërsjella** për t'i dhënë një kuptim më njerëzor, politik, kulturor, mjedisor dhe ekonomik të gjithë Mesdheut. Vënia në jetë e këtyre ndryshimeve nuk mund që të ndërhyjë në mënyrë të qëndrueshme e të bashkërenduar pa mobilizimin e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut që ata të dëgjohen dhe të kontribuojnë në mënyrë të lirë në formësimin e një fjale dhe të një veprimi qytetar të përbashkët. Puna jonë merr parasysh, sigurisht, iniciativat e formave të ndryshme¹ të iniciuara nga shumë institucione shtetërore, parlamentare dhe joqeveritare, të shqetësuara për të krijuar një hapësirë të qëndrueshme paqeje, zhvillimi, solidariteti dhe prosperiteti të bashkërenduar.

2. OBJEKTIVAT

Asambleja e Qytetarëve dhe e Qytetareve të Mesdheut që tani kërkon që të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- kontribuojë në ndërtimin e një hapësire mesdhetare të qëndrueshme paqeje, zhvillimi, solidariteti dhe prosperiteti të bashkërenduar midis popujve. Në bazë të pyetjes “*Cili është Mesdheu që duam ne?*”, ne kërkojmë që të promovojmë ndërhyrjen qytetare në gjirin e një ndërtimi të ri politik rajonal, ekonomik dhe social për zonën e Mesdheut;
- të marrë pjesë në formësimin e qeverisjeve të reja të bashkërenduara dhe të përpjesshme në hapësirën Mesdhetare;
- të veprojnë për të arritur integrimin ekonomik dhe politik në një kuadër rajonal, duke i mundësuar kështu disa popujve që të dalin nga izolimi i tyre;
- të veprojnë për të tejkaluar shqetësimet e ndërsjella për t'i dhënë një kuptim më njerëzor, politik, kulturor, mjedisor dhe ekonomik një komuniteti mesdhetar të popujve;
- të kontribuojë në dialogun midis shoqërive.

3. NATYRA DHE PRINCIPET

Një asamble e qytetarëve dhe qytetareve është një proces veprimi dhe i urtësisë kolektive (nga ku del edhe koncepti i asamblesë) e cila tejkalon kuadrin e ekspertizës tradicionale (nga ku del edhe koncepti i qytetarëve) i cili kërkon që të prodhojë propozime dhe elementë të rinj mirëkuptimi.

¹ Si është edhe procesi i Barcelonës dhe Bashkimi për Mesdheun, Asambleja Parlamentare Euro-mesdhetare, Forumet civile dhe Forumet sociale rajonale.



FUNDACIÓN ASAMBLEA DE CIUDADANOS Y CIUDADANAS DEL MEDITERRÁNEO (FACM)
FONDATION ASSEMBLÉE DES CITOYENS ET CITOYENNES DE LA MÉDITERRANÉE (FACM)
MEDITERRANEAN CITIZENS' ASSEMBLY FOUNDATION (MCAF)
مؤسسة مجلس مواطني و مواطنات المتوسط

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut është organizuar si një hapësirë dialogu të vazhdueshëm midis shoqërive –me të gjitha pjesët që i përbëjnë – të Mesdheut. Bëhet fjalë për një proces afatgjatë që bashkon aktorë të ndryshëm të shoqërisë – lëvizje qytetare, institucione publike dhe private, ndërmarje, shoqata, sindikata, ekspertë, universitete, qendra kërkimi etj.

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut kërkon që të ndihmojë në rithemelimin e një qytetarie të re, të bazuar mbi përgjegjësinë, dialogun dhe shpërndarjen.

Një Asamble e qytetarëve dhe qytetareve frymëzohet nga tre principe:

- ajo lejon para së gjithash të identifikojë ndryshimet më të mëdha dhe sfidat që na presin;
- ajo kërkon që të ndërtojë perspektiva të përbashkëta duke marrë në konsideratë karakteristikat e ndryshme gjeografike dhe socio-profesionale të situatave dhe të pikëpamjeve;
- ajo themelon demokracinë mbi identifikimin e vlerave, interesave, sfidave dhe angazhimeve të përbashkëta, që janë ngjitësi i vërtetë i komunitetit – dhe bazamenti i “të jetuarit bashkë”.

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut nuk ka status juridik, ajo është para së gjithash një proces, dhe jo një institucion. Ajo është në të njëjtën kohë:

- një **aventurë e përbashkët**;
- një vizion, **për tu ndërtuar, ai i një komuniteti mesdhetar**;
- një vullnet: **të dalin nga pafuqia** për të kuptuar dhe influencuar, nëpërmjet bashkimit të forcave, të realiteteve shkalla dhe kompleksiteti i të cilave tejkalojnë secilin prej nesh individualisht;
- një hapësirë **reciprociteti** të iniciativave, refleksioneve dhe mësimi.

4. VLERA TË PËRBASHKËTA

Një Asamble e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut (A.Q.M.) është pjesë e një **vizioni humanist dhe progresiv** të zhvillimit historik të tërësisë së Mesdheut dhe të gjithë planetit. Ky vizion bazohet mbi **vlerat demokratike**, të lirisë të solidaritetit, të paqes, të respektit të shumëllojshmërisë kulturore dhe të përgjegjësisë mjedisore. Kjo hapësirë në mund të mirëpresë presona që mbartin ide të cilat janë në kundërshtim me principet dhe vlerat e përbashkëta:

- A.Q.M.-ja është pluraliste si nga identitetit dhe natyra e aktorëve të ftuar për të bashkëbiseduar, aq edhe nga drejtimet filozofike, politike dhe fetare që ajo përfaqëson;



- A.Q.M.-ja favorizon një etikë të shumëllojshmërisë dhe të bashkimit. Secili është i gatshëm që t'i njohë tjetrit karakteristikat e tij të veçanta. Por në tërësi pjesëmarrësit kërkojnë që të ndërtojnë një administrim të qëndrueshëm dhe solidar të sfidave të përbashkëta të njerëzimit;
- Analiza e të shkuarës nuk kërkon asnjëherë që të çojnë në gjykime rreth personave apo qytetërimeve por të krijojë perspektiva për të ardhmen;
- A.Q.M.-ja nuk kërkon që të zëvendësojë institucionet ekzistuese të bashkëpunimi. Secili prej tyre ka arsytet e tij të ekzistencës. A.Q.M.-ja kërkon që të jetë një hapësirë dialogu e favorshme për formësimin e bashkëpunimeve të reja që do të gjejnë edhe ato mënyrat personale për tu vënë në jetë pa kërkuar mbështetjen e A.Q.M.-së.
- A.Q.M.-ja nuk kërkon që të ndërtojë koalicione që do të jenë në kundërshtim me të tjerët. Përkundrazi, ajo kërkon që shkëmbimet që ajo lind të jenë po aq të nevojshme sa edhe dialogë të tjerë ndër rajonalë apo botërorë.

Në kuadër të A.Q.M., pjesëmarrësit integrohen personalisht. A.Q.M. nuk është vendi ku të shprehen pikëpamjet e institucioneve: ekzistojnë hapësira të tjera për negociatat ndër-institucionale. Kur liria e fjalës është e papërputhshme kryerjen e përgjegjësisë institucionale, A.Q.M. do të favorizojë aktorët që kanë një eksperiencë dhe që përgjegjësitë e tyre aktuale nuk u detyrojnë që të kenë rezerva. Përgjegjësit e A.Q.M. zotohen që:

- Ta shëndrojnë A.Q.M. në një hapësirë të hapur, tolerante dhe mirëpritës;
- Ta bëjnë A.Q.M. të njohur duke arritur promovimin në rrethet e tyre respektive;
- Të shpërndajnë eksperiencën e tyre dhe të mirëmbajnë lidhje të privileguara me pjesëmarrës të tjerë
- Të respektojnë rregullat e punës së vendosura në mënyrë të përbashkët;
- Të pranojnë që pjesëmarrja e tyre në A.Q.M. të jetë publike.

5. RREGULLAT E PUNËS

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut

Asambleja e Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut sa si qëllim të paraqesë para së gjithash përfundime të përbashkëta, dhe të përkufizojë një vizion dhe perspektiva kolektive përballë sfidave të shekullit të XXI-të.

Në një moment të dytë, bëhet fjalë për të vënë në dialog perspektivat e secilit për të formësuar prioritete, strategji të përbashkëta, propozime konkrete – që do të mund të shërbejnë, midis të tjerash për të orientuar veprimet politike dhe publike. Në përputhje me vizionin tonë rreth atij



që ndërton një shoqëri, pjesëmarrësit e këtyre takimeve do të dalin nga numër i gjerë shtresash sociale, profesionale dhe kulturore të Mesdheut.

Koordinimi i Mesdheut

Ky organ është themeluar nga organizata të shoqërisë civile me qëllime jofitimprurëse që venë në dispozicion të iniciativës burime njerëzore dhe materiale të nevojshme dhe që kanë si kapacitet të sigurt për të mobilizuar financime. Është përgjegjëse për zhvillimin, ndjekjen e iniciativës koordinimin e politikave dhe zbatimin e tyre.

Anëtarët e Koordinimit mesdhetar i nënshtrohen dhe respektojnë shpirtin e etikës të këtij Dokumenti themelues. Ato kujdesen që ky Dokument të respektohen nga të gjithë pjesëmarrësit. Në rastet e divergjencave që paraprake midis protagonistëve apo pjesëmarrësve të A.Q.M. për sa i përket Dokumentit Themelues, Koordinimi mesdhetar do të luajë një rol arbitrimi – me mbështetjen e Këshillit nëse kjo është e nevojshme.

Sistemi i informacioni të A.Q.M. duhet të sigurojë transparencën e aktivitetit të Koordinimit mesdhetar.

Koordinimi mesdhetar ka përgjegjësinë e kërkimi të financimeve, të cilësisë dhe të transparencës së administrimit.

Koordinimi mesdhetar mund të zgjerohet gjeografikisht në funksion të nevojave dhe të zhvillimit të aktiviteteve të tij.

Këshilli

Për të promovuar këtë proces është ndërtuar një këshill konsultativ. Anëtarët e tij janë përcaktuar nga Koordinimi mesdhetar. Numri i anëtarëve nuk është i kufizuar. Këshilli mbledhet me kërkesë të Koordinimit mesdhetar, që mund të thërrasë të gjithë ose një pjesë të anëtarëve të tij, në funksion të tematikave që ka për të shqyrtuar.

Ai formohet nga persona vullnetarë që vijnë nga rajone të ndryshme të Mesdheut. Anëtarët zgjidhen sipas aftësive që kanë për:

- Të tu mobilizuar në nivelin lokal apo rajonal;
- Për të kryer ekspertiza;
- Për të qenë persona publikë;
- Për të luajtur rolin e ndërmjetësit, si me qytetarët ashtu edhe me institucionet.

Anëtarët e këshillit kanë si rol që:

- Të ndihmojnë Koordinimin mesdhetar për të ndërtuar një projekt nga ana politike;



- T'i përgjigjen konsultimeve të ndërrmarra nga Koordinimi mesdhetar;
- Të kontribuojnë në hartimin e teksteve të reflektimit strategjik në fushat politike, sociale, kulturore dhe mjedisore;
- Të ndihmojnë Koordinimin mesdhetar për të vlerësuar iniciativat.
- T'i përgjigjen ftesave të Koordinimit mesdhetar në kuadër të zgjidhjes së konflikteve eventuale midis protagonistëve apo pjesëmarrësve.
- Të ndihmojnë vlerësimin dhe vënien në jetë të Grupeve lokale (shih më poshtë).

Grupet lokale të qytetarëve dhe qytetareve të Mesdheut

Kjo iniciativë kërkon gjithashtu që të promovojë dhe të krijojë Grupet lokale të Qytetarëve dhe të qytetareve të Mesdheut në vende të ndryshme mesdhetare. Të konceptuara si hapësira dialogu të vazhdueshëm dhe të hapura midis qytetarëve, ato organizohen duke u nisur nga ballafaqimi i ideve (diskutime, tavolina të rumbullakëta), nga përpunimi i përbashkët dhe vlerësimi i propozimeve me qëllim formësimin e politikave të reja ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore.

Çdo qytetar dhe qytetare mund të marrë pjesë në këto Grupe me kusht që ai apo ajo të jetë dakord me principet e këtij Dokumenti Themelues dhe të angazhohet që do t'i respektojë ato.

Grupet e qytetarëve janë informate, përveç se në rastet kur konteksti politik i një vendi nuk e lejon këtë; në këtë rast, Koordinimi mesdhetar i jep atyre një model Statuti që ata mundën që ta përdorin. Ekzistenca e një grupi i nënshtrohet një njohjeje formale nga ana e Koordinimit Mesdhetar.

Çdo grup cakton një person referent, që është i ngarkuar për të kryer lidhjet dhe marrëdhëniet me Koordinimin mesdhetar dhe me grupet e tjera.

Metodat

Decentralizimi si gjeografik ashtu edhe institucional i iniciativës dhe i aktiviteteve të saj supozon që ka në përdorim mjete profesionale dhe të vlefshëm bashkëpunimi. Të shqetësuar për të përdorur sa më mirë të gjithë fazat e Asamblesë, Koordinimi mesdhetar ka në përdorim:

- Një qendër të burimeve dhe një sistem informacioni;
- Një mjet novator i cili mundëson realizimin e sintezave që respektojnë mendimin e gjithsecilit.

Tërësia e procesit të Asamblesë të Qytetarëve dhe Qytetareve të Mesdheut bazohet pjesërisht mbi mjete dhe metoda bashkëpunuese. Këto mjete, që ne do të përdorim kur ta shohim të nevojshme, do të konsiderohen si një element thelbësor i procesit tonë.